

Anëtarësimi në sistemin AIPS i një pjesëmarrësi të ri.

Fazat e anëtarësimi.

- I. Anëtarësimi në AIPS CUG, AIP Fin Y – Copy.
- II. Testimi dhe trainimi.
- III. Përgatitja e dokumentacionit.
- IV. Implementimi dhe kalimi në *live*.

FAZA E PARË. Anëtarësimi në AIPS CUG, AIP Fin Y – Copy.

1. Plotësimi i Formsit të SWIFT në www.SWIFT.com “ SWIFT Service Form for FIN-Y Copy ”.
2. Aprovimi në www.SWIFT.com nga Aprovuesit e autorizuar pranë Bankës së Shqipërisë.
3. Shtimi i pjesëmarrësit në AIPS CUG nga S.W.I.F.T.

FAZA E DYTË. Testimi dhe trainimi.

1. Testimi i VPN

- a. instalimi dhe konfigurimi i VPN në ambientet e bankës kandidate;
- b. përgatitja e kërkesës për përdorues në VPN nga banka kandidate;
- c. krijimi i përdoruesve të VPN nga Banka e Shqipërisë;
- d. testimi i VPN nga banka kandidate dhe Banka e Shqipërisë.

2. Testimi i SWIFT

- a. shkëmbimi i çelësve TEST SWIFT të bankës kandidate me 2 destinacione TEST bankave pjesëmarrëse në AIPS dhe me Bankën e Shqipërisë;
- b. instalimi/Konfigurimi i PATCH AIP Fin Y-Copy në serverin SWIFT të bankës kandidate;
- c. testimi i AIP Fin Y-Copy nga banka kandidate, Banka e Shqipërisë dhe një bankë e tretë.

3. Trainimi / Testimi në sistemin AIPS

- a. nga banka pjesëmarrëse do të paraqitet kërkesa për përdorues në TEST;
- b. nga Banka e Shqipërisë përgatiten kartat e sigurisë, të cilat iu dorëzohen pjesëmarrësve dhe krijohen gjithashtu, përdoruesit në ambjentin TEST;

- c. Banka e Shqipërisë do të trainojë dy deri në tre punonjës të bankës kandidate për funksionalitetin e sistemit AIPS;
- d. banka kandidate në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë do të ekzekutojë scriptin e testimit dhe do ta firmosin atë.

FAZA E TRETË. Përgatitja e dokumentacionit.

- a. banka kandidate do të përgatisë “Rregullat dhe procedurat e brendshme të funksionimit të AIPS” në përputhje me këtë rregullore;
- b. dokumentacioni i përfunduar do të dorëzohet pranë Bankës së Shqipërisë për aprovim;
- c. Banka e Shqipërisë bën vërejtjet/modifikimet e saj nëse bien ndesh me këtë rregullore dhe të tjera të Bankës së Shqipërisë, dhe ia pasqyron bankës kandidate;
- d. banka kandidate sjell në variantin përfundimtar për “Rregullat dhe procedurat e brendshme të funksionimit të AIPS” të përpunuara.

FAZA E KATËRT. Implementimi dhe kalimi në *live Environment*.

- a. përgatitja dhe dorëzimi i çertifikatës së pjesëmarrjes nga Banka e Shqipërisë për bankën kandidate;
- b. nënshkrimi i kontratës tip të pjesëmarrjes ndërmjet Bankës e Shqipërisë dhe bankës pjesëmarrëse;
- c. banka pjesëmarrëse duhet të ketë shkëmbyer çelësa S.W.I.F.T në *live* me të gjitha bankat pjesëmarrëse në AIPS, dhe me destinacionet e AIPS pranë Bankës së Shqipërisë;
- d. pjesëmarrësi përgatit dhe dorëzon pranë Bankës së Shqipërisë “Formular për pjesëmarrje në AIPS” [shtojca C](#);
- e. pjesëmarrësi plotëson dhe dorëzon pranë Bankës së Shqipërisë “Kërkesën për pajisje sigurie dhe përdorues në ambientin *live*” [shtojca E](#);
- f. pjesëmarrësi plotëson dhe dorëzon pranë Bankës së Shqipërisë “Kërkesë për ndryshime në rrjetin VPN ” [shtojca F](#);
- g. pas miratimit të kërkesave nga Banka e Shqipërisë krijohet profili i pjesëmarrësit në AIPS, përgatiten kartat e sigurisë me çertifikatat e përdoruesve, krijohen përdoruesit në ambientin AIPS LIVE, krijohen përdoruesit në VPN, i dorëzohen pajisjet e sigurisë pjesëmarrësit;
- h. Banka e Shqipërisë përcakton ditën e kalimit *live* të pjesëmarrësit dhe njofton me email të gjithë pjesëmarrësit e AIPS;
- i. kalimi në *live*.